



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/549
Datë: 13/11/2020

Rektori i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 25 dhe 28 të Statutit, në zbatim të rekomandimit nr. 2/545, dt. 13.11.2020, të Konferencës së Rektorëve përgjigjes së MASH në shkresën nr. 3081 të datës 11.11.2020 dhe propozimit të Senatit nga mbledhja e datës 22.10.2020, lëshon këtë

V E N D I M


Për plotësimin e kuotave të rezervuara për komunitetin jo shumicë dhe për kandidatë nga viset e tjera jashtë Kosovës, të banuara me shqiptarë sipas konkurseve të të gjitha niveleve të studimeve për pranim në vitin akademik 2020/21

1. Të plotësohen vendet e pa plotësuara nga afati i parë i konkurseve për të gjitha nivelet e studimeve në kuadër të kuotave të rezervuara për komunitetin jo shumicë dhe për kandidatë nga viset e tjera jashtë Kosovës, të banuara me shqiptarë.
2. Plotësimi i këtyre vendeve do të bëhet me kandidatë nga programet/profilet e njëjta studimore në të cilat kanë aplikuar për pranim në vitin akademik 2020/21, gjithnjë duke respektuar listën prioritare të kandidatëve të pa pranuar për shkak të plotësimit të vendeve të parapara në kategorinë e caktuar sipas konkursit.
3. Pas publikimit të këtij vendimi në ueb-faqe të UP-së dhe informimit individual të kandidatëve nga lista prioritare (renditja sipas pikëve) përmes postës elektronike (email-it), kandidati brenda 24 orëve duhet deklarohet me shkrim nëse është i interesuar për pranim ose jo.
4. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij vendimi, në qoftë se në programet/profilet e njëjta në afatin e parë të konkursit nuk ka pasur kandidatë në listë të pritjes për arsye të mos arritjes së pragut të kalueshmërisë, plotësimi i vendeve të lira do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të këtij njoftimi me kandidatë të cilët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë së provimit pranues në afatin e dytë të konkursit.
5. Kandidatët të cilët në afatin e parë të konkursit në programin/profilin përkatës kanë qenë në listën prioritare të pritjes si kandidatë të pa pranuar (të renditur me pikë brenda numrit të vendeve të lira nga kuotat e rezervuara), ndërsa në afatin e dytë të konkursit kanë konkurruar dhe janë pranuar në programe/profile tjera studimore, kanë të drejtë të zgjedhin se në cilin program studimor do të vazhdojnë studimet.

6. Procedura e regjistrimit të kandidatëve të cilët në bazë të këtij vendimi fitojnë të drejtën e regjistrimit, me kusht që MASH të shtyj afatin për regjistrim dhe dorëzim të të dhënave në SMIAL, do të bëhet në Administratën Qendrore më së largu deri ditën premte, datë 20.11.2020 në ora 15.30.
7. Vendimi do të zbatohet nga shërbimi i studentëve në Administratën Qendrore të Universitetit të Prishtinës.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Menaxhmentit të UP-se;
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Dekanëve të njësive akademike të UP-së,
5. Sekretarëve të njësive akademike;
6. Administratorit të bazës së të dhënave;
7. Drejtorit të zyrës për çështje të studentëve në AQ;
8. Parlamentit të studentëve, dhe
9. Për publikim në ueb-faqe.



Prof. Dr. Naser Sahiti

N. Sahiti
Rektor i UP-së